



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SELENICË
NJËSIA E PROKURIMIT**

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATES –Sherbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “ORGANIZIM FESTASH NE BASHKINE SELENICE”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 79952000-2 sherbime te organizimit te eventeve

Vlera e fondit limit: 4,166,000 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjet e gjashtë mijë) Lekë, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor **Bashkia Selenice**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Argumentimi : Për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe VKM Nr 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, neni 76, sipas të cilit përcaktohet se në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Në përfundim të punës grupi u referua në nenin 76 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, pika a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, etj); b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; si dhe c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore.

Afati i realizimit të kontratës është 8 Muaj.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentim Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Këto kërkesa bazohen në nenin 76 “Kriteret detyruese për s’kualifikim”, neni 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”, dhe neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1 të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar:

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimi sipas shtojcës 10*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar si dhe në ligjin 9 723, datë 03.05.2007 ”Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare 2023,2024,2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30 % i vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 shkronja c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar . Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosja e këtij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2. Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të tre viteve të fundit 2023, 2024,2025 të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivit . Shenim: Ne respektojmë të VKM nr. 285, date 19.05.2021” Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43, pika 4, e ndryshuar, kjo kerkese do të konsiderohet e përmbushur nqs dy bilancet e njepasneshme nuk kane raport negativ ndermjet aktivitetit dhe pasivit.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetuesinë e informacionit të paraqitur në zbatim të Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021” Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar nenit 43, pika 4 te VKM-së Nr.285 datë 05.03.2009 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar , si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Ligjin nr.10091“Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.i cili parashikon se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij. neni 61 të ligjit Nr. 29/2023 ”Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 26, datë 08.09.2023 ”Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe ligjit Nr. 25/2018 ”Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës

2.2.3 Operatorët Ekonomike pjesëmarrës duhet te deklaroje qe ka shlyer te gjitha taksat dhe tarifat vendore leshuar nga të gjitha Njësitë Vendore ku Operatori ekonomik ka ushtruar aktivitet gjatë vitit 2025 duke përfshirë këtu këstet e maturuara të vitit 2026, dhe duke e bazuar ne për të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit sipas Ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Biznesit për të cilat duhet të paraqesi një vërtetim nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin sipas përcaktimeve te ligjit te Prokurimit Publik dhe të Ligjit nr.Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i ka shlyer detyrimet e taksave dhe të tarifave vendore për do të dorëzohët vetëm nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari përpara publikimit te njoftimit te fituesit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, e LPP, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Vendosja e kërkesës për detyrimet vendore është bërë në mbështetje të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, sipas të cilit operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrojnë aktivitet, në Ligjin Nr. 9 920, datë 19.05.2008 ”Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, neni 40, në ligjin Nr. 131/2015 ”Për QKB” i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr. 9 723, datë 03.05.2007 ”Për QKR”, i ndryshuar. Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet qe ushtrojne aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuaduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendor.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 35 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter u vendos edhe në përputhje me piken 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuara se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të kenë në staf personelin teknik prej 8 (tete) punonjësish të nevojshëm për realizimin e shërbimit objekt prokurimi, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruara nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri I punonjësve për periudhën e fundit të deklaruara nga data e hapjes së ofertave. Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për 3 muajt e fundit **Janar 2026 - Mars 2026** të deklaruara nga data e hapjes së ofertave shoqëruar me formularet e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. **Punonjësit** si më poshtë:

- a) 1 (një) Fotograf
- b) 1 (dy) Videograf
- c) 1 (një) Teknik Audio
- d) 1 (një) grafik- dizajner
- e) 1 (një) Rregjisor
- f) 1 (një) Specialist Marketingu
- g) 1 (një) Përgjegjës shërbimi,
- h) 1 (një) Koordinator logjistike

Për punonjësit sipas pikave sa më sipër duhet të paraqitet:

- diplomë e shkollës së lartë dhe/ose Dëshmitë e aftësisë profesionale/ ose Çertifikata të lëshuara nga organizma vendas apo të huaj, që vërtetojnë se punonjësi ka njohuri në fushën e grafik-dizajnit, fotografisë, videografisë, teknikë audio;

- kontratë pune ose kontratë shërbimi/angazhimi apo çdo marrëveshje tjetër kontraktuale, të vlefshme gjatë afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër, për secilin profil

Për punonjësën sipas pikës g, h) duhet të paraqitet:

- kontratë pune ose kontratë shërbimi/angazhimi apo çdo marrëveshje tjetër kontraktuale, të vlefshme gjatë afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër, për secilin profil;

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesat për punonjës të kualifikuar janë të bazuara në shërbimet që do të realizohen, si dhe në pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Këto dispozita kërkojnë që operatorët ekonomikë të provojnë se disponojnë personelin e kualifikuar të nevojshëm për realizimin e suksesshëm të objektit të prokurimit. Autoriteti kontraktor duhet të sigurojë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për zbatimin e suksesshëm të kontratës dhe realizimin e objektit të prokurimit, përfshirë këtu edhe kërkesat për një staf të kualifikuar. Kërkesat për punonjës të lartpërmendur janë hartuar në përputhje me termat e references.

Fotograf (1) – Një fotograf është kërkuar për të mbuluar ngjarjet me shërbim fotografik të plotë, duke siguruar imazhe për arkiv dhe për përdorim në postime online dhe portale. Fotografitë do të përdoren për promovimin e eventit në media sociale, broshura dhe web faqe, duke rritur dukshmërinë dhe angazhimin e audiencës.

Videograf (1) – Po ashtu, është kërkuar një videograf për të krijuar video promovuese, video me animim dhe video prezantuese. Këto video do të ndihmojnë në tërheqjen e audiencës, përhapjen e mesazhit të eventit dhe rritjen e dukshmërisë, duke siguruar një eksperiencë vizuale dhe dinamike që ka për qëllim të arrijë audiencën e duhur.

Teknik Audio (1) – Një teknik audio është i domosdoshëm për realizimin e programit artistik që përfshin këngëtarë, grupe muzikore dhe DJ. Ky profesionist do të menaxhojë të gjitha pajisjet audio, përfshirë mikrofonat, altoparlantët dhe mikserët, duke siguruar një cilësi të lartë të zërit gjatë eventit.

Grafik-Dizajner (1) – Përgatitja e materialeve vizuale është një pjesë kyçe e ngjarjes. Grafikdizajneri do të krijojë dhe printojë materialet promovuese për eventin, duke siguruar që dokumentet dhe materialet vizuale të jenë të përgatitura në formatet e duhura për printim në cilësi të lartë dhe të jenë tërheqëse dhe funksionale për promovim.

Rregjisor (1) – Rregjisori është përgjegjës për konceptimin e reklamës, duke siguruar që aktorët, valltarët, dhe muzikantët të interpretojnë rolet e tyre me profesionalizëm dhe harmoni. Ai gjithashtu do të menaxhojë ekipin xhirues për të krijuar një reklamë koherente dhe emocionuese.

Specialist Marketingu (1) – Një specialist marketingu është i domosdoshëm për të promovuar ngjarjen, duke siguruar që ajo të arrijë audiencën e duhur. Ai do të krijojë dhe zbatojë një strategji promovuese, do të menaxhojë kanalet digjitale dhe rrjetet sociale, dhe do të monitorojë performancën e eventeve për të rritur ndikimin dhe angazhimin.

Përgjegjës Shërbimi (1) – Ky profesionist është përgjegjës për sigurimin e komfortit dhe mbështetjes për pjesëmarrësit. Ai do të koordinojë dhe mbikëqyrë shërbimet që ofrohen gjatë ngjarjes, si orientimi i pjesëmarrësve, ofrimi i informacionit mbi programin dhe asistencën për kërkesa të tjera.

Koordinator Logjistikë (1) – Për të menaxhuar kompleksitetin e eventit, koordinatori i logjistikës do të sigurojë që të gjitha pajisjet dhe materialet të jenë të disponueshme dhe funksionale. Ai do të koordinojë transportin, menaxhimin e infrastrukturës, dhe do të jetë përgjegjës për organizimin e detajeve logjistike, duke siguruar që ngjarja të zhvillohet në mënyrë efikase dhe pa ndërprerje.

Ky ekip specialistësh do të mundësojë realizimin e një eventit të suksesshëm dhe të pandërprerë, duke përmirësuar përvojën e audiencës dhe rritur ndikimin e ngjarjes në media dhe në komunitet.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë ku të deklarojnë se:

- Marrin përsipër transportimin, montimin, mbarëvajtjen teknike, çmontimin dhe largimin e pajisjeve pas përfundimit të çdo aktiviteti, të gjitha pajisjet teknike të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit në vendin përkatës, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

- Disponojnë pajisjet teknike për realizimin e objektit të prokurimit, sipas specifikimeve teknike.

Argumentimi: Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Duke analizuar elementët përbërës të objektit të prokurimit, me anë të deklaratave të sipërcituara, AK krijon siguri se ofertuesi do të marrë përsipër realizimin e eventit (duke përfshirë transportimin, montimin, çmontim, mbarëvajtje teknike, etj. të pajisjeve teknike dhe disponimin e tyre, pa kosto shtesë nga oferta fillestare.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë te pakten mjetet dhe makinerite e mëposhtme:

| | | |
|---------------------|--------------|------------------------|
| Mjet me kosh | cope 1 (nje) | Ne pronesi ose me qera |
| Komioncin 1 - 3 ton | cope 1 (nje) | Ne pronesi ose me qera |

a) Dokumentacion që vërteton pronësinë ose marrjen me qera:

➤ *Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj / Kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit / Çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

➤ *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*

Kontratë qiraje.

Ne cdo rast të shoqeruara me:

1. Leje qarkullimi e mjetit;
2. Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore;
3. Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve;
4. Fotot përkatëse;

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo faturat e shitjes të shoqeruara me dokumentacion pronësie të shitesit (zhdoganim apo kontrata blerjeje) si dhe fotot, ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave e cila duhet të jete për të gjithë periudhën e realizimit deri në përfundimin e plotë të kontratës.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Operatori ekonomike fitues duhet të paraqesë përpara njoftimit të fituesit dokumentacionin vërtetues të vetdeklaruar.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Mjeti me kosh do të jete i nevojshem për montimin e banderolave, sistemimin e ndricimit të ambienteve, etj. të cdo feste që do të organizohet.

Komioncin 1 - 3 ton do të jete e nevojshem për transportimin e materialeve sic janë skena dhe elemente të tjera plotësues.

Argumentimi i specifikimeve teknike:

1) 5- Maji (Fshati Mavrovë)

Specifikimet teknike:

Dekori ku të ketë të përfshirë: shirita me flamuj trekëndor 300m linear, flamuj normal me përmasa 0.9m x 1.4m 50 copë, flamuj vertikal me përmasa 3.3m x 0.7m 50 copë.

Banderola me përmasa 8x1 m materiali plastik (foto)

Karrige me material plastik/metalike

Fonia të përfshij: Audio + Dj .

1) Audio hd 2000 wat 4 satelita .

2) Subwufer 2000w 4 cop.)

3) Mikrofon wirlees për prezantim + 3 me stativë.

4) Dj suport & mixazh muzikë.

Kurora me lule 3 (tre) dhe 5 (pesë) tufa me lule.

Koktejl për 50 persona ku të jenë të përfshirë Freskuse të ndryshme, snack të ndryshme.

Set fotografish & Filmim me kamer të përfshij: filmimin me kamer + dron, foto, klip përmbledhës (të gjitha materialet e filmuara dhe fotografuara të dorëzohen me disk dhe usb).

2) Amantia Fest 31.05.2026 Ploçë.

Specifikimet teknike:

Dekori ku të ketë të përfshirë ndriçim ambjenti 300m linear me shirit llampash, shirita me flamuj trekëndor 300m linear, flamuj normal me përmasa 0.9m x 1.4m 50 copë, flamuj vertikal me përmasa 3.3m x 0.7m 50 copë.

Banderola me përmasa 8x1 m materiali plastik (foto)

Baner: Me përmasa 4x3m me material plastik me mbishkrim (foto)

Karrige me material plastik/metalike

Skena + foni me përmasa 6x4m ku të përfshij urën, ndriçimine skenës dhe foni.

Audio .

1) - Hd 5000 wat 6 cop satelit.

2) Subwufer 4 cop 4000.wat.

3) Monitor audio skenik 4 cop x 500 wat.

4) Mikrofonta wirles 4 cop + 3 Mikrofonta Condenser polifonik.

5) Mixer audio multitrak rekorder.

6) Dixhej suport skenik.

Ndricimi.

1) Pare led rgb 20 copë.

2) Ndricim i bardhe folow spot 6 copë.

3) American truss 8 m + stativa skenik.

4) Robota 10 cop (beam)

Topa futbollit dhe volejbollit cilësor për zhvillimin e aktiviteteve sportive.

Kupa futbollit, volejbollit dhe boksi material plastik, ku të shërbejnë si trofe për fituesit e garave sportive të cilat do të zhvillohen në aktivitetet.

Cetifikata të jetë material karton, modeli si në (foto)

Ring boksi me përmasa 5m x 5m ku të zhvillohen ndeshjet e boksit.

Rrjetë volejbollit për zhvillimin e ndeshjeve të volejbollit.

Transporti automjete për transportin e nxënësve të shkollave pjesëmarrëse në këtë aktivitet.

Koktejl për 70 persona ku të jenë të përfshirë Freskuse të ndryshme, snack të ndryshme.

Set fotografish & Filmim me kamer të përfshij: filmimin me kamer + dron, foto, klip përmbledhës (të gjitha materialet e filmuara dhe fotografuara të dorëzohen me disk dhe usb).

3) Festivali Folklorik i Shkollave “Brez pas Brezi” (1 Qerahor 2026) Gjorm

Specifikimet teknike:

Dekori ku të ketë të përfshirë ndriçim ambjenti 300m linear me shirit llampash, shirita me flamuj trekëndor 300m linear, flamuj normal me përmasa 0.9m x 1.4m 50 copë, flamuj vertikal me përmasa 3.3m x 0.7m 50 copë.

Banderola me përmasa 8x1 m materiali plastik (foto)

Baner: Me përmasa 4x3m me material plastik me mbishkrim (foto)

Karrige me material plastik/metalike

Skena + foni me përmasa 6x4m ku të përfshij urën, ndriçimine skenës dhe foni.

Audio .

1) - Hd 5000 wat 6 cop satelit.

2) Subwufer 4 cop 4000.wat.

3) Monitor audio skenik 4 cop x 500 wat.

4) Mikrofonta wirles 4 cop + 3 Mikrofonta Condeser polifonik.

5) Mixer audio multitrak rekorder.

6) Dixhej suport skenik.

Ndricimi.

1) Pare led rgb 20 copë.

2) Ndricim i bardhe folow spot 6 copë.

3) American truss 8 m + stativa skenik.

4) Robota 10 cop (beam)

Kupa festivalit material plastik, me simbol artistik muzikor, ku të shërbejsi trofe për fituesin e vendit të parë të festivalit.

Cetifikata të jetë material karton, modeli si në (foto)

Diploma të jetë material karton, modeli si në (foto)

Transporti automjete për transportin e nxënësve të shkollave pjesëmarrëse në këtë aktivitet.

Koktejl për 80 persona ku të jenë të përfshirë Freskuse të ndryshme, snack të ndryshme.

Set fotografish & Filmim me kamer të përfshijë: filmimin me kamer + dron, foto, klip përmbledhës (të gjitha materialet e filmuara dhe fotografuara të dorëzohen me disk dhe usb).

4) 106- Vjetori i Luftës së Vlorës (5 Qershor) (Drashovicë - Kotë)

Specifikimet teknike:

Dekori ku të ketë të përfshirë: shirita me flamuj trekëndor 300m linear, flamuj normal me përmasa 0.9m x 1.4m 50 copë, flamuj vertikal me përmasa 3.3m x 0.7m 50 copë.

Banderola me përmasa 8x1 m materiali plastik (foto)

Karrige me material plastik/metalike

Fonia të përfshij: Audio + Dj .

1) Audio hd 2000 wat 4 satelita .

2) Subwufer 2000w 4 cop.)

3)Mikrofon wirlees per prezantim + 3 me stativ.

4) Dj suport & mixazh muzikë.

Kurora me lule 3 (tre) dhe 5 (pesë) buqeta me lule.

Koktejl për 50 persona ku të jenë të përfshirë Freskuse të ndryshme, snack të ndryshme.

Baner: me përmasa 3x2m me material plastik dhe mbishkrim (foto)

Set fotografish & Filmim me kamer të përfshij: filmimin me kamer + dron, foto, klip përmbledhës (të gjitha materialet e filmuara dhe fotografuara të dorëzohen me disk dhe usb).

5) Çelja e Sezonit “Shushica Fest” 15 Qershor Brataj

“Shushica Fest” 15 Qershor, Konsiston me një aktivitet të turizmit lumor në lumin Shushicë.

Specifikimet teknike:

Fonia të përfshij: Audio + Dj .

1) Audio hd 2000 wat 4 satelita .

2) Subwufer 2000w 4 cop.)

3)Mikrofon wirlees per prezantim + 3 me stative.

4) Dj suport & mixazh muzikë.

Banderola me përmasa 8x1m me mbishkrimin (foto)

Baneri me përmasa 3x2 m , material plastik. (foto)

Koktejl për 50 persona ku të jenë të përfshirë Freskuse të ndryshme, snack të ndryshme.

Set fotografish & Filmim me kamer të përfshij: filmimin me kamer + dron, foto, klip përmbledhës (të gjitha materialet e filmuara dhe fotografuara të dorëzohen me disk dhe usb).

6) Festivali Folklorik Edicioni IV 07-08-09 Gusht. Kotë

Specifikimet teknike:

Dekori ku të ketë të përfshirë ndriçim ambjenti 300m linear me shirit llampash, shirita me flamuj trekëndor 300m linear, flamuj normal me përmasa 0.9m x 1.4m 50 copë, flamuj vertikal me përmasa 3.3m x 0.7m 50 copë.

Banderola me përmasa 8x1m me material plastik me mbishkrim (foto)

Karrige me material plastik/metalike për të 3 (netë) të festivalit.

Set fotografish & Filmim me kamer të përfshij: filmimin me kamer + dron, foto, klip përmbledhës (të gjitha materialet e filmuara dhe fotografuara të dorëzohen me disk dhe usb).

Koktejl për 100 persona ku të jenë të përfshirë Freskuse të ndryshme, snack të ndryshme për çdo natë të festivalit.

7) “Sevasteri Fest” 12.08.2026

Specifikimet teknike:

Fonia të përfshij: Audio + Dj .

1) Audio hd 2000 wat 4 satelita .

2) Subwufer 2000w 4 cop.)

3)Mikrofon wirlees per prezantim + 3 me stative.

4) Dj suport & mixazh muzikë.

Set fotografish & Filmim me kamer të përfshijë: filmimin me kamer + dron, foto, klip përmbledhës (të gjitha materialet e filmuara dhe fotografuara të dorëzohen me disk dhe usb).

8) “Ramica Fest” 22.08.2026

Specifikimet teknike:

Fonia të përfshij: Audio + Dj .

1) Audio hd 2000 wat 4 satelita .

2) Subwufer 2000w 4 cop.)

3)Mikrofon wirlees per prezantim + 3 me stative.

4) Dj suport & mixazh muzikë.

Set fotografish & Filmim me kamer të përfshijë: filmimin me kamer + dron, foto, klip përmbledhës (të gjitha materialet e filmuara dhe fotografuara të dorëzohen me disk dhe usb).

9) "Gorrishti Fest" 26.08.2026

Specifikimet teknike:

Fonia të përfshij: Audio + Dj .

1) Audio hd 2000 wat 4 satelita .

2) Subwufer 2000w 4 cop.)

3)Mikrofon wirlees per prezantim + 3 me stative.

4) Dj suport & mixazh muzikë.

Set fotografish & Filmim me kamer të përfshijë: filmimin me kamer + dron, foto, klip përmbledhës (të gjitha materialet e filmuara dhe fotografuara të dorëzohen me disk dhe usb).

10) "Vajzë Fest" 21-22-23- Gusht

Specifikimet teknike:

Skena të jetë me përmasa 6x4 ku të përfshihen:

1- SISTEM LED WALL MIN 5X3 ML

Led Wall pixel P3.9 Outdoor

Frekuenc Rate 3470x1400

Contrast 1: 10000

Montuar mbi Stage me strukturen perkatese ose i varur ne

Truss Katerkendor mbeshtetur mbi dy Elevatore me peshembajtje mbi 750kg

2-Sistemi Audio

-Mixer Audio min 16 ch Mikrofonik +Digital Efekte on board.

- Mikrofone Dinamik apo Condenser Mikrofon per VOKAL cope 6

- Radio Mikrofone Wireless Handle dhe Head Set cope 2-3

- Sound Sistem Audience

* Subwoofer 2-4 cope me fuqi mbi 1000 ëat

* Boxe Audio Line Array (Satelit min 12 " cope 6-8 qe te sigurojnë vlerën 90-110 dB)

* Monitor Audi (kthyes per ne skene) 3 cope (2 way ose Coaxial 12-15" + Tweter 4 ") min 65-80dB

- Stative perkates dhe kablllo mikrofonik

3- Podi i Skenes (Stage Modular) per realizimin e siperfaqjes se performaces se grupeve polifonike min 6x4 ml (24 m2) dhe lartesi 80 -140 cm kompletuar me shkallet ne te dy krahet e Skenes.

Peshembajtja e Stage jo më i vogel se 750 kg / m2

4-Sistemi i Ndricimit

Per realizimin e sistemit te ndricimit skenik nevoiten ndricues Skenik (Prozhektore Led min 200w 5600-6500 Kelvin) per ndricimin frontal i majftueshem per regjistrim Televiziv) 6-10 cope plotesuar me Stativet perkates.

Ndricimi Skenik me ndricues ROBOTIK

(Beam, Spot ,Wash) 12 - 16 cope

Ndricues Linear (Barra LED) 12-24 Pika ndricimi RGBË 15ëat cope 12-16

Dekori ku të ketë të përfshirë ndriçim ambjenti 300m linear me shirit llampash, shirita me flamuj

trekëndor 300m linear, flamuj normal me përmasa 0.9m x 1.4m 50 copë, flamuj vertikal me përmasa 3.3m x 0.7m 50 copë.

Banderola me përmasa 8x1 m materiali plastik (foto)

Karrige me material plastik/metalike për të 3 (netë) të festivalit.

Banner me përmasa 4x3m me mbishkrim (foto)

Koktejl për 100 persona ku të jenë të përfshirë Freskuse të ndryshme, snack të ndryshme për çdo natë të festivalit.

Set fotografish & Filmim me kamer të përfshij: filmimin me kamer + dron, foto, klip përmbledhës (të gjitha materialet e filmuara dhe fotografuara të dorëzohen me disk dhe usb).

11) Epopeja e Drashovicës (15 Shtator)

Specifikimet teknike:

Dekori ku të ketë të përfshirë ndriçim ambjenti 300m linear me shirit llampash, shirita me flamuj trekëndor 300m linear, flamuj normal me përmasa 0.9m x 1.4m 50 copë, flamuj vertikal me përmasa 3.3m x 0.7m 50 copë.

Banderola me përmasa 8x1 m materiali plastik (foto)

Baner: me përmasa 3x2m, material plastik dhe me mbishkrim (foto)

Karrige me material plastik/metalike

Foni ku të përfshihen mikrofonat , bokse

Kurora me lule 5 (pesë) dhe 5 (pesë) tufa me lule

Karrige me material plastik/metalike

Set fotografish & Filmim me kamerë të përfshijë: filmimin me kamerë + dron, foto, klip përmbledhës (të gjitha materialet e filmuara dhe fotografuara të dorëzohen me disk dhe usb).

Koktejl për 60 persona ku të jenë të përfshirë Freskuse të ndryshme, snack të ndryshme

12) Festa e Verës dhe Ullirit 9 Tetor 2026

Specifikimet teknike:

Dekori ku të ketë të përfshirë ndriçim ambjenti 300m linear me shirit llampash, shirita me flamuj trekëndor 300m linear, flamuj normal me përmasa 0.9m x 1.4m 50 copë, flamuj vertikal me përmasa 3.3m x 0.7m 50 copë.

Banderola me përmasa 8x1m me mbishkrimin (foto)

Baner me përmasa 4x3 material plastik dhe me mbishkrim (foto)

Skena me përmasa 6x4m ku të përfshijë urën, ndriçimin e skenës dhe fonit.

Audio .

1) - Hd 5000 wat 6 copë satelit.

2) Subwufër 4 copë 4000.wat.

3) Monitor audio skenik 4 copë x 500 wat.

4) Mikrofonat wirless 4 copë + 3 Mikrofonat Condenser polifonik.

5) Mixer audio multitrak rekorder.

6) Dixhej suport skenik.

Ndricimi.

1) Pare led rgb 20 copë.

2) Ndricim i bardhë follow spot 6 copë.

3) American truss 8 m + stativa skenik.

4) Robota 10 copë (beam)

Artizan: Të përfshihen prodhuesit dhe përpunuesit tradicional të produkteve të rrushit, ullirit dhe pentarive të tjera të zonës.

Karrige me material plastik/metalike

Set fotografish & Filmim me kamerë të përfshijë: filmimin me kamerë + dron, foto, klip përmbledhës (të gjitha materialet e filmuara dhe fotografuara të dorëzohen me disk dhe usb).

13) Festat e nëntorit 28-29 Nëntor

Specifikimet teknike:

Dekori ku të ketë të përfshirë: shirita me flamuj trekëndor 300m linear, flamuj normal me përmasa 0.9m x 1.4m 50 copë, flamuj vertikal me përmasa 3.3m x 0.7m 50 copë.

Fonia të përfshijë: Audio + Dj .

1) Audio hd 2000 wat 4 satelita .

2) Subwufër 2000w 4 copë.)

3)Mikrofonat wirless për prezantim + 3 me stativë.

4) Dj suport & mixazh muzikë.

Banderola me përmasa 8x1m me mbishkrim (foto)

Koktejl për 50 persona ku të jenë të përfshirë Freskuse të ndryshme, snack të ndryshme.

Kurora me lule 3 (tre) dhe 5 (pesë) buqeta me lule

Set fotografish & Filmim me kamer të përfshij: filmimin me kamer + dron, foto, klip përmbledhës (të gjitha materialet e filmuara dhe fotografuara të dorëzohen me disk dhe usb).

14) Festat e Fundvitit – Ndezja e Dritave Të Pemës, 11.12.2026

Specifikimet teknike:

Fonia të përfshij: Audio + Dj .

1) Audio hd 2000 wat 4 satelita .

2) Subwufer 2000w 4 cop.)

3)Mikrofon wirlees per prezantim + 3 me stativ.

4) Dj suport & mixazh muzikë.

Set fotografish & Filmim me kamer të përfshij: filmimin me kamer + dron, foto, klip përmbledhës (të gjitha materialet e filmuara dhe fotografuara të dorëzohen me disk dhe usb).

Fishekzjarre profesionale të kategorisë F3 me 49 shkrepje progresive (kalibër 25mm), me kohëzgjatje 45 sekonda dhe lartësi shpërthimi 30m, i përbërë nga efekte vizuale 'Golden Brocade' dhe 'Red Peony' me finale shpërthyes, i pajisur me bazament stabilizues dhe fitil sigurie për ndezje të vetme.

Topa zbkurues për pemën ø15-20cm, material plastik ABS i pathyeshëm (shatterproof) me ngjyra të ndryshme, rezistent ndaj rrezeve UV dhe kushteve atmosferike, me kokë siguroese metalike për varjen në ambiente të jashtme.

Fjongo zbkuruese për pemën me ngjyra të ndryshme, me përmasa 20x40cm, e punuar me shirit të gjerë 10cm me skaje teli, me trajtim 'Weather-Proof' dhe material që ruan formën 3D.

Kristale dëbore zbkurues për pemën me akrilik (shatterproof), me ngjyra të ndryshme, me gjatësi 25-30cm, me transparencë të lartë dhe prerje gjeometrike 'diamond-cut' për reflektim maksimal të dritës, i pajisur me vrimë siguroese për varje në ambiente të jashtme.

Zile zbkurues për pemën Zile dekorative profesionale H15cm, material plastik ABS i pathyeshëm me veshje metalike 'Weather-Proof', unazë të siguar dhe rezistencë ndaj rrezeve UV

Shirit (Zinxhir) dritash LED me gjatësi 10 metra, me kablllo gome të trashë (jo plastikë) dhe izolim maksimal kundër shiut e borës (IP65), që mund të lidhen deri në 15-20 rrotulla me një prizë të vetme.

Shënim: Operatori ekonomik fitues për nënshkrimin e një kontratë/dorëzimin e faturës tatimore duhet të ketë:

1. Kopje të Certifikatës elektronike të Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qëndrore të Faturave.
2. Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softueri në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softuerike.

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Personi Pergjegjes:

Specialist fushe:

Fondin Limit: